

AKTI I THEMELIMIT I SHOQËRISË “FUEGO HOSPITALITY” SH.P.K.

Sot më datë 01 Dhjetor 2022, **Z. Miguel Ramirez**, i datëlindjes 04.01.1979, lindur në Nevada, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe banues në Tiranë, Shqipëri shpreh vullnetin për hartimin e këtij Akti Themelimi të Shoqërisë “**Fuego Hospitality**” sh.p.k. si më poshtë vijon:

1. Forma ligjore e shoqërisë

Shoqëria “**Fuego Hospitality**” sh.p.k., nga këtu e më poshtë në këtë akt, e referuar si shoqëria, themelohet si një shoqëri tregtare në formën e “Shoqërisë me Përgjegjësi të kufizuar”, shkurtimisht SHPK.

2. Ortakët themelues

Shoqëria është themeluar nga Ortaku i Vetëm Z. Miguel Ramirez.

3. Objekti i veprimtarisë

Objekti i aktivitetit të shoqërisë “**Fuego Hospitality**” sh.p.k. do të jetë:

Bar - Restorant. Organizim eventesh artistike. Paketim dhe ambalazhim produkteve ushqimore. Tregëti, import-eksport dhe çdo lloj aktiviteti tregëtar të lejuar nga ligji.

4. Selia e shoqërisë

4.1 Selia e Shoqërisë “**Fuego Hospitality**” sh.p.k. do të jetë në Tiranë, në adresën: Rruga "Ilo Mitkë Qafëzezi" Nd. 2, Kati I, Njësia Administrative Nr. 5.

4.2 Shoqëria mund të vendosë të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.

5. Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë të papërcaktuar nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregëtar.

6. Kapitali i shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare “**Fuego Hospitality**” sh.p.k. është 100.000 Lekë.

E gjithë pjesa e kapitalit themeltar është nënshkruar në tërësinë e saj nga Ortaku i Vetëm themelues.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet edhe me kontribute në natyrë.

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themelor të **Shoqërisë** bëhet me vendim të **Asamblesë së Ortakëve**. Fondi në të holla që vjen nga shlyerja e pjesëve të kapitalit themeltar depozitohet për llogari të **Shoqërisë** në të gjitha Bankat që ndodhen në territorin e Shqipërisë.

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar bëhet me akt noterial.

7. Drejtimi dhe Administrimi

Shoqëria drejtohet nga Asambleja e Ortakëve dhe Administratori.

Administratori i parë i shoqërisë "**Fuego Hospitality**" sh.p.k. është **Z. Miguel Ramirez**.

Administratori emërohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, për një periudhë jo më shumë se 5 vjet.

Përfaqësimi i shoqërisë tregtare "**Fuego Hospitality**" sh.p.k. në marrëdhënie me të tretët dhe brenda kufijve që i njeht ligji dhe Statuti, i përket Administratorit të saj. Ai ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë edhe në organet gjyqësore apo të ngarkojnë për këtë qëllim një zyrë avokatie në mbrojtje të interesave të Shoqërisë.

h

8. Shpërbërja dhe likuidimi

Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkakut ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, privimin për të ushtruar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe të çdo faktori tjetër që nuk varet nga vullneti i ortakëve të shoqërisë.

Ortaku i Vetëm

Miguel Ramirez

